

Asylum Advice

Përpara intervistës
fillestare të
regjistrimit



Section 2:

Përpara intervistës fillestare të regjistrimit

2.1 Njohja me procesin e regjistrimit për azil

Home Office është angazhuar që t'ju trajtojë me respekt, dinjitet dhe paanësi pavarësisht moshës, kombësisë, racës, gjinisë, orientimit seksual, fesë ose besimit.

United Kingdom Visas and Immigration (UKVI), një departament i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar që është përgjegjës për kërkesën tuaj për azil duhet të vendosë nëse jeni në rrezik në vendin tuaj dhe ju nevojitet mbrojtje ndërkombëtare në Mbretërinë e Bashkuar.

Ka disa faza të ndryshme në procesin e azilit dhe sa kohë zgjasin ato varet nga rrethanat tuaja, por ju nuk do të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar gjatë kohës që shqyrtohet kërkesa juaj.

Faza e parë është normalisht një intervistë për regjistrimin fillestar dhe kjo kryhet kur ju aplikoni fillimisht për azil. Arsyeja kryesore për intervistën fillestare të regjistrimit është që të përcaktojë identitetin tuaj, si keni ardhur në Mbretërinë e Bashkuar dhe çfarë nevojash të veçanta mund të keni.

Ju duhet t'i përgjigjeni pyetjeve themelore që ju bëhen në fazën e regjistrimit. Intervista juaj e zgjeruar (intervista kryesore për azil) do të bëhet në një datë të mëvonshme. Gjatë intervistës tuaj të zgjeruar duhet të shpjegoni përse ju dhe familja juaj doni të kërkonin azil në Mbretërinë e Bashkuar dhe përse po kërkonin mbrojtje. Procesi i regjistrimit për azil është që të regjistrojë kërkesën tuaj për të kërkuar azil, të regjistrojë të gjitha të dhënat tuaja personale dhe t'ju kërkojë {1}shkurtimisht{2} hollësi mbi situatën tuaj. Do të pyeteni edhe nëse preferoni të intervistoheni nga një oficer mashkull ose nga oficerë femër. Në këtë fazë nuk do t'ju kërkojnë informacione të detajuara rreth kërkesës tuaj për azil.

Ju lutemi vini re se informacioni që jepni në intervistën e zgjeruar do të kontrollohet nëse përputhet me atë që keni thënë në intervistën fillestare të regjistrimit.

Ju duhet të jeni të sqartë në të gjitha komunikimet me Home Office.

Nëse telefononi për të caktuar një takim në Asylum Intake Unit për një intervistë regjistrimi do t'ju bëhen disa pyetje bazë në telefon, të cilat do të keni mundësinë

t’i konfirmoni kur të paraqiteni në takim tuaj. Ju lutemi vini Home Office në dijeni nëse ju ose njerëzit që keni në ngarkim ndiheni të cënuar apo për ndonjë nevojë të menjëhershme.

Numri i telefonit për Asylum Intake Unit: 0208 196 4524. E Hënë deri të Enjten, 9pd deri në 4.45md, E Premte 9pd deri në 4.30md.

2.2 Procesi i regjistrimit për Azil

Nëse po aplikoni për azil në Asylum Intake Unit dhe doni që ndonjë prej personave që varen nga ju (si për shembull partneri apo partnerja, ose fëmijët nën 18 vjeç) të bëjnë pjesë në aplikimin tuaj për azil, ju duhet t’i sillni ata me vete. Keni të drejtën të aplikoni për azil si një vartës por mund të dëshironi të paraqisni kërkesën tuaj të veçantë për azil nëse keni informacion të veçantë që doni të merret parasysh.

Pasi të mbërrini në Asylum Intake Unit mund t’ju duhet të prisni në recepsion derisa të thirreni në një dhomë interviste. Procesi i regjistrimit zgjat disa orë prandaj mund të doni të merrni diçka me vete për të ngrënë dhe për të pirë, nëse është e mundur. Asylum Intake Unit ka mjedise për familje si për shembull dhoma intervistash për familje që kanë vende të veçanta që fëmijët tuaj të luajë, vizatojnë ose të shikojnë televizor. Megjithatë, mundet që të merrni aktivitete me vete ose të merrni një mik apo mikeshë që t’ju ndihmojë e të kujdeset për fëmijët tuaj.

Procesi i regjistrimit për azil është ndarë në disa pjesë. Ato përfshijnë:

- Grumbullimi i informacionit tuaj biometrik (do t’ju marrin shenjat e gishtërinjve dhe do t’ju bëjnë fotografi). Informacioni juaj biometrik do të grumbullohet dhe do të ruhet në një kartë që ju jepet gjatë procesit të regjistrimit. Kjo kartë quhet Karta e Aplikimit për Regjistrim (ARC). Ajo konfirmon se keni kërkuar azil dhe regjistron identitetin që i jepni Home Office. Nëse ju jepet e drejta për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuara, konfirmimin e të drejtës tuaj për të qëndruar do ta merrni nëpërmjet kartës biometrike të lejes së banimit, që ju jepet të gjithë të huajve që kanë të drejtën të punojnë dhe të jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar. Karta biometrike e lejes së banimit konfirmon statusin tuaj të imigracionit dhe kushtet e të drejtës tuaj për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar.
- Kryerja e kontrollove mbi identitetin dhe sigurinë.
- Konfirmimi nëse ju nevojitet apo jo strehim dhe grumbullimi i informacionit për të ndihmuar në marrjen e një vendimi se ku do të strehoheni në Mbretërinë e Bashkuar.
- Kryerja e një interviste regjistrimi në të cilën do t’ju bëhen:
 - Pyetje themelore rreth identitetit tuaj dhe detajeve të familjes tuaj.

- Konfirmimi se kur duhet të raportoni (Shih Pjesën e raportimit për më shumë informacion).
- Si keni udhëtuar deri në Mbretërinë e Bashkuar.
- Nëse keni ndonjë problem shëndetësor.
- Të jepni një shpjegim të shkurtër përse jeni larguar nga vendi juaj.
- Pyetje që kanë të bëjnë me çdo dënim penal që mund të keni dhe çdo pyetje të nevojshme në lidhje me sigurinë kombëtare.
- Nëse preferoni që të keni një femër apo një mashkull që t'ju intervistojë gjatë intervistës tuaj të zgjeruar.
- Nëse jeni të pastrehë duhet të informoni Home Office për nevojat e familjes tuaj. Pas intervistës tuaj të regjistrimit, Home Office do të konsiderojë nëse do t'ju dërgojë në strehim të përkohshëm. Vendimi do të merret në bazë të mundësisë që ju mund të mbeteni të të pastrehuar. Duhet të informoni Home Office për çdo problem shëndetësor që mund të keni ju ose personat që varen nga ju dhe;
- Nëse ju kanë mbaruar barnat
- Nëse ju nevojitet ndihmë mjekësore
- Nëse jeni viktimë e torturës
- Nëse jeni trafikuar ose po trafikoheni dhe/ose po shfrytëzoheni
- Nëse fëmijët kanë një prind tjetër në Mbretërinë e Bashkuar
- Nëse fëmijët po japin provime përfundimtare në shkollë
- Nëse jeni shtatzënë.

Home Office do të shqyrtojë informacionin që i jepni dhe do të marrë një vendim rreth vendit se ku do t'ju ofrohet strehimi i përkohshëm. Ky vend strehimi do të jetë në një qendër të përkohshme. Nuk mund ta zgjidhni ju strehimin por Home Office do ta marrë parasysh situatën tuaj.

Pasi aplikimi juaj të jetë regjistruar, do të merret vendimi nëse duhet të mbaheni të ndaluar. Nëse ndaloheni, aplikimi juaj do të jetë pjesë e procesit të përshpejtuar për personat e ndaluar dhe vendimi mbi aplikimin tuaj do të merret shpejt. Nëse ndaloheni, arsyeja për këtë veprim do t'ju shpjegohet. Si pjesë e procesit të përshpejtuar të shqyrtimit për personat e ndaluar do t'ju jepet mundësia që të merrni përfaqësim ligjor falas dhe do të intervistoheni plotësisht rreth kërkesës tuaj për azil.

Nëse kërkesa juaj për azil refuzohet, ju mund të mbaheni në ndalim derisa të largoheni

nga Mbretëria e Bashkuar. Nëse kualifikoheni për apel brenda vendit, apli do të bëhet ndërkohë që ju mbaheni të ndaluar.

2.3 Domosdoshmëria për të qenë të sinqertë

Mund t'ju kenë këshilluar të mos i thoni Home Office rreth disa prej aspekteve të kërkesës tuaj ose mund të jeni këshilluar edhe që të jepni një histori krejt të ndryshme. Nëse e bëni, kjo gjë do të jetë e dëmshme për çështjen tuaj dhe ka të ngjarë që të çojë në refuzim. Është e domosdoshme që ju të thoni të vërtetën.

Nëse bëni një kërkesë për azil të pabazuar ose abuzive, përfshi një kërkesë të vonuar ose oportuniste, ka të ngjarë që të refuzoheni dhe do t'ju largojnë pasi kërkesa juaj të jetë përpunuar. Në rrethana të caktuara apelet mund të bëhen vetëm pas largimit nga Mbretëria e Bashkuar.

Është shkelje kriminale të përdorni mashtrimin ose të paraqisni dokumente të rreme për të mbështetur aplikimin dhe mund të ndiqeni penalisht e mund të futeni në burg nëse e bëni këtë gjë.

2.4 Çfarë duhet të prisni gjatë intervistës tuaj të regjistrimit

Gjatë intervistës tuaj të regjistrimit, Home Office duhet të marrë vetëm informacion bazë nga ju. Ata duhet marrin parasysh nevojat tuaja. Ata po ashtu duhet të vlerësojnë se si të vendosin për kërkesën tuaj. Për shembull, nëse vini nga një vend i cili nuk konsiderohet se ka probleme të mbrojtjes, ka të ngjarë të ndaloheni dhe çështja juaj të vendoset shpejt (shqyrtimi i përshpejtuar ndërkohë që mbaheni të ndaluar). Nëse keni hyrë në një vend tjetër të sigurt më parë gjatë udhëtimit tuaj për në Mbretërinë e Bashkuar dhe oficerët e imigracionit të atij vendi ju kanë takuar, çështja juaj mund t'i referohet Third Country Unit në Home Office. Kjo do të thotë se Home Office mund t'i kërkojë zyrtarëve në atë vend që ta shqyrtojnë kërkesën tuaj për azil atje. Për këtë mund t'ju duhet të ktheheni në atë vend. Home Office mundet që po ashtu të vendosë se jeni nga një shtet që ka probleme me sigurinë dhe ta shqyrtojë me shpejtësi çështjen tuaj për të siguruar një dhënie më të shpejtë të statusit të refugjatit. Home Office do t'ju trajtojë me drejtësi dhe paanësi dhe do të marrë një vendim vetëm bazuar në ligjin përkatës. Ju lutem vini re se ju keni të drejtën të kërkonit një kopje të intervistës tuaj të regjistrimit.

2.5 Përkthyesit

Nëse ju nevojitet do t'ju ofrohet një përkthyes ose përkthyes. Nëse keni caktuar një takim atëherë përkthyesi apo përkthyesja duhet të jenë të pranishëm. Mund t'ju duhet të prisni për një përkthyes që të vijë nëse po përdorni shërbimin e paraqitjes në person dhe po regjistrohni pasi keni mbërritur.

Home Office do t'ju ofrojë një përkthyes ose përkthyesë për intervistën e regjistrimit, nëse ju nevojitet dhe përkthyesit duhet të përkthejnë saktë atë që thoni në mënyrë që Home Office të ketë shënime të plota të informacionit që jepni. Ju mund të kërkontë për një përkthyes mashkull ose femër, varet si preferoni.

Përkthyesve ju kërkohet që çdo informacion që jepni ta trajtojnë si rreptësisht konfidencial.

Ju lutemi thuajini oficerëve intervistues nëse keni ndonjë shqetësim rreth përkthyesit apo përkthyeses, për shembull nëse keni vështirësi për t'i kuptuar. Kjo nuk ndikon mbi atë se çfarë vendoset për çështjen tuaj ose mbi rezultatin e çështjes tuaj.

2.6 Si të ankoheni

Nëse nuk jeni të kënaqur me shërbimet që janë ofruar ose mendoni se personeli, përkthyesit ose çdokush që ka lidhje me Home Office nuk ju ka trajtuar me respekt ose dinjitet, ose jeni të shqetësuar mbi sjelljen profesionale, atëherë mund të bëni një ankesë. Është e rëndësishme që ju të bëni një ankesë sa më parë që të jetë e mundur pas ngjarjes. Home Office normalisht nuk nuk i heton ankesat që janë më të vjetra se 3 muaj.

Ju duhet që ankesën ta bëni me shkrim. Ajo mund të shkruhet vetëm në anglisht ose ulla. Nëse jeni në Mbretërinë e Bashkuar do të duhet që ta dërgoni me:

- Email: complaints@homeoffice.gsi.gov.uk. Normalisht Home Office ju përgjigjet më shpejt ankesave me email.
- Ose me postë: UKVI, Complaints Allocation Hub, Kati i 11të, Lunar House, Wellesley Road, Croydon, CR9 2BY.

Ju duhet të siguroheni që në ankesë të përfshihet ç'ka më poshtë:

- emri, mbiemri dhe të dhënat e plota të kontaktit;
- gjithë të dhënat e ankesës (përfshi orën, datat dhe vendet);
- emrat ose numrat identifikues të çdo personeli të drejtpërdrejtë apo të një kontraktori të UK Visas & Immigration me të cilët keni folur;
- të dhënat e gjithë dëshmitarëve (nëse është e përshtatshme);
- kopje të letrave ose dokumenteve përkatëse;
- numrat e referencës tuaj nga Home Office.

Ankesa juaj do të menaxhohet nga një prej Customer Service Units të Home Office. Ata

do të jenë përgjegjës që ankesa juaj të zgjidhet në kohë dhe në mënyrë të pranueshme. Home Office do t'ju dërgojë një konfirmim e do t'ju thotë se kush po e shqyrton ankesën tuaj. Ata normalisht do t'ju japin një përgjigje të plotë brenda 20 ditësh. Megjithatë, nëse ankesa juaj pretendon se ka pasur shkelje të rënda profesionale mund të duhen deri në 12 javë, pasi do të kryhet një hetim i pavarur. Bërja e një ankese nuk do të ndikojë mbi vendimin për çështjen tuaj, ose nuk do të ketë ndikim negativ mbi rezultatin e çështjes tuaj.

Nëse ju nevojitet më shumë informacion në lidhje me këtë ju lutemi kontaktoni:

Asylum Advice UK në numrin 0808 8000 620

2.7 Dokumentet që duhet të merrni me vete tek Asylum Intake Unit

Duhet të siguroheni që të jepni gjithë dokumentacionin që keni në dispozicion sa më parë, për të mbështetur kërkesën tuaj për azil.

Pasaporta - pasaporta juaj dhe pasaportat e gjithë personave që varen nga ju të përfshirë në kërkesën tuaj për azil.

Dokumentet e udhëtimit - çdo biletë dhe kartat e bordit që keni.

Certifikata të regjistrimit në polici - nëse ju ose familja juaj i keni këto certifikata.

Çdo lloj dokumenti tjetër identifikimi - si për shembull karta identifikimi, certifikata lindjeje, martese, të shkollës, karta anëtarësimi, etj.

Kjo bëhet që të ndihmohet Home Office të përcaktojë identitetin dhe kombësinë tuaj.

Dokumentet mjekësore - Home Office duhet të dijë të dhënat e çdo problemi mjekësor që keni dhe gjithë barnat që merrni.

Evidencë mbi akomodimin tuaj - nëse keni jetuar në Mbretërinë e Bashkuar tashmë, Home Office do t'ju kërkojë evidencë me shkrim si për shembull kontrata të qiramarrjes ose fatura komunale të kohëve të fundit (për shembull të gazit, elektricitetit, etj) që tregojnë emrin, mbiemrin dhe historinë e adresave tuaja në Mbretërinë e Bashkuar.

Nëse jetoni në shtëpinë e dikujt tjetër, ju lutemi sillni një letër të kohëve të fundit nga i zoti i shtëpisë ku të konfirmohet nëse mund të qëndroni në shtëpinë e tyre DHE evidencë me shkrim si për shembull fatura komunale që tregojnë emrin, mbiemrin dhe adresën e plotë të të zotit të shtëpisë.

Nëse ju nevojitet akomodim i përkohshëm, duhet të sillni prova përse akomodimi juaj ekzistues nuk ju ofrohet më dhe perse nuk jeni më në gjëndje për të mbështetur veten. Home Office do të shqyrtojë nëse keni ndonje pasuri ose mbështetje tjetër në Britaninë e Bashkuar ose jashtë vendit.

Home Office do t'ju marrë dokumentet tuaja origjinale dhe do t'i mbajë ato deri sa të jetë shqyrtuar kërkesa juaj për azil. Mund të kërkonti një fotokopje të dokumenteve tuaja pasi ato do t'ju kthehen vetëm mbasi çështja juaj të jetë përfunduar.

2.8 Akomodimi dhe mbështetja e Azilit

Kur të bëni në intervistën tuaj të regjistrimit do të pyeteni nëse ju nevojitet akomodim dhe mbështetje. Do të bëhen kontrolle për të parë nëse i plotësoni kriteret për mbështetje.

Nëse ju nevojitet akomodim dhe mbështetje:

Nëse ju nevojitet akomodim është e rëndësishme që t'i merrni të gjitha sendet tuaja me vete në intervistën e regjistrimit. Nëse pranohet se ju nevojitet akomodim dhe se nuk keni mundësi tjetër perkrahjeje për veten atëherë ju do të vendoseni direkt në një qendër akomodimi fillestar të përkohshëm pas intervistës tuaj të regjistrimit. Kjo qendër mund të jetë shumë kilometra larg. Ju duhet të informoni oficerin për çdo nevojë urgjente që keni, sepse kjo mund të ndikojë se në cilën qendër do të dërgoheni. Ky është akomodim i përkohshëm dhe ka të ngjarë që ju të qëndroni këtu për rreth 21 ditë. Megjithatë, kjo periudhë mund të jetë më e gjatë në vartësi të rrethanave tuaja individuale.

Është e rëndësishme që nëse nuk mund ta mbështesni veten, të mund t'ia provoni këtë Home Office. Home Office do ta shqyrtojë situatën tuaj financiare si në Mbretërinë e Bashkuar ashtu dhe jashtë. Nëse i keni disa mundësitë që të mbështesni veten ose keni miq apo të afërm që mund t'ju mbajnë me akomodim dhe ushqim atëherë Home Office pret që ju të mbështesni veten.

Home Office pret që ju të paraqisni evidencën e mëposhtme për ju dhe të varurit tuaj:

- Pasqyra bankare - 6 muaj për të gjitha llogaritë bankare në Mbretërinë e Bashkuar dhe jashtë vendit. Ata gjithashtu do të kontrollojnë për të parë nëse janë transferuar fonde nga llogaria juaj që ju ende mund të keni në zotrim.
- Të dhëna për gjitha asetet - nëse këto mund të shiten për të mundësuar mbështetjen tuaj.
- Informacion rreth punës që mund të keni bërë në Mbretërinë e Bashkuar - duhet një kopje e P45 ose letër nga punëdhënësi juaj që konfirmon se puna ka përfunduar dhe kur përfundoi.

- Të dhënat mbi të ardhurat dhe si janë shpenzuar këto të ardhura - faturat, marrëveshjet, dëshmi se si janë shpenzuar këto para
- Çdo bizhuteri me vlerë
- Prona në Mbretërinë e Bashkuar dhe jashtë, konfirmim për në qoftë se kjo mund të shitet
- Gjithë paratë që mund të keni ose keni pasur kur keni hyrë në Mbretërinë e Bashkuar dhe ku janë keto para dhe nëse janë ende në dispozicion
- Çdo ndihmë financiare që merrni në Mbretërinë e Bashkuar. Dëshmi se kjo ndihmë ka ndaluar, ose konfirmim të shumës dhe sa shpesh kjo është tërhequr.

Pasi keni arritur në stehimin fillestar, anëtarët e Migrant Help janë në dispozicion aty për t'ju dhënë këshilla dhe informacion të pavarur falas. Një takim do të organizohet sa më shpejt të jetë e mundur për të kopletuar Formularin e UK Visas & Immigration Asylum Support (ASF1). Ju lutemi të sillni të gjitha dokumentet tuaja dhe evidencen mbështetëse.

Akomodimi fillestar është një akomodim i llojit të bujtinës ku ju ofrohen vaktet e ngrënies dhe sendet bazë të tualetit. Nuk do t'ju jepet asnjë lloj ndihme financiare ndërkohë që jeni në akomodimin fillestar. Në Skoci strehimi fillestar është vetë-gatim ushqimi dhe aplikuesit marrin £5 për ditë kundrejt kostos së produkteve higjienike dhe ushqimit.

Nëse aplikimi juaj për mbështetje është i suksesshëm, do të çoheni në akomodimin tuaj shpërndarës. Ky akomodim mund të jetë kudo në Mbretërinë e Bashkuar dhe ofrohet pa ju dhënë mundësinë të zgjidhni. Prandaj është e rëndësishme që të njoftoni Home Office për çdo faktor që mund të ndikojë mbi zonën dhe llojin e akomodimit ku do të vendoseni. Është e rëndësishme që ju ta bëni këtë kur plotësoni formularin e aplikimit përndryshe mundet që akomodimi juaj të mos jetë i përshtatshëm për nevojat tuaja.

Ju lutemi diskutoni gjithë nevojat tuaja me punonjësit e Asylum Support Application kur të plotësoni aplikimin tuaj për mbështetje.

Nëse po jetoni me një mik apo mikeshë ndërkohë që prisni akomodimin, mbështetja financiare nuk do të fillojë derisa të keni shkuar në akomodimin tuaj afatgjatë. Nëse ju keni qenë të strehuar me miqë apo familjarë dhe duhet të gjeni strehim diku tjetër është shumë e rëndësishme që ju kontaktoni Migrant Help në 0808 8000 621 sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo të prisni derisa ju jeni të pastrehë. Nëse jeni duke qëndruar diku përkohësisht është përgjithësisht më mirë të qëndroni atje në mënyrë që Home Office ti jepet mundësia të shqyrtojë aplikimit tuaj, te gjejë strehimin më të përshtatshëm për ju dhe të fillojë shpërndarjen në rajonet e tjera.

Nëse nuk ju nevojitet akomodim

Nëse po jetoni te miq apo familjarë duhet të paraqisni prova se mund të jetoni aty. Nëse ata mund t'ju ofrojnë vetëm akomodim, por nuk ju ofrojnë mbështetje tjetër atëherë mund të aplikoni për mbështetje financiare (vetëm për të jetuar).

Nëse ju nevojitet akomodim

Nëse miqtë dhe familja mund t'ju ofrojnë ushqim ose keni disa të ardhura të pakta, mund të aplikoni vetëm për akomodim te Home Office.

Është e rëndësishme që ju të kontaktoni Asylum Support Application UK për të paraqitur një aplikim për mbështetje nëse ju nevojitet.

Asylum Support Application UK - 0808 8000 621
www.asylumhelpuk.org

Nëse po aplikoni vetëm për ndihmë financiare për jetesë dhe po jetoni te miqtë, mbështetja financiare nuk do të fillojë derisa ju të jeni vlerësuar se kualifikoheni për mbështetje.

Nëse keni qenë në Mbretërinë e Bashkuar për një kohë të gjatë dhe nuk keni kërkuar azil menjëherë pasi të ishte e mundur, mund t'ju refuzohet mbështetja nga Home Office.

Nëse nuk mund të provoni se nuk keni një vend të përshtatshëm për të qëndruar dhe/ose nuk keni akses te gjëra që nevojiten për jetën (ushqim, ngrohje) ose që mosdhënia e mbështetjes do të shkelë të drejtat tuaja të njeriut, atëherë Home Office ka të drejtën t'ua refuzojë mbështetjen.

2.9 Çfarë ndodh nëse unë nuk jam në gjendje të kujdesem për veten?

Home Office do t'i vlerësojë nevojat tuaja kur të kryeni intervistën tuaj të regjistrimit. Mund të vendoset se nuk mund të kujdeseni për veten tuaj.

Kjo mund të ndodhë sepse keni një sëmundje të rëndë, paaftësi fizike, paaftësi në të nxënë, probleme me shëndetin mendor ose dobësi për shkak të moshës së thyer. Nëse aplikohet njëra prej këtyre, atëherë mund të referoheni te shërbimet sociale pasi të regjistrohemi me ta për të plotësuar një Vlerësim të Kujdesit në Komunitet. Nëse keni një nevojë të qartë dhe të menjëhershme për kujdes, ka të ngjarë që autoriteti vendor të jetë përgjegjës që t'ju ofrojë mbështetje. Kjo mund të përfshijë akomodim dhe mbështetje financiare.

Nëse ju nevojitet mbështetje shtesë por nuk keni një nevojë të qartë dhe të

menjëhershme për kujdes, do të kryhet një Vlerësim i Kujdesit në Komunitet kur të dërgoheni në akomodimin tuaj afatgjatë. Vlerësimi do të vendosë nëse ju duhet ndihmë shtesë (p.sh. pajisje).

Nëse ka një fëmijë në familjen tuaj me nevojë të qartë për kujdes (për shembull për shkak të invaliditetit të rëndë ose një sëmundjeje të rëndë) atëherë do të jetë e nevojshme që autoritetet lokale të sigurojnë që të ofrohet niveli i duhur i kujdesit gjatë kohës që ju jeni në procesin e azilit nën sistemin e Home Office.

Do të duhet të bëhet një referim te shërbimet e fëmijëve për t'u siguruar që po ofrohet mbështetja e duhur.

Nëse ju nevojiten këshilla dhe udhëzime për ta bërë këtë, ju lutemi kontaktoni:

Asylum Advice UK - 0808 8000 620
www.asylumhelpuk.org

2.10 Dokumentet që ju jepen pas regjistrimit

Karta e Aplikimit për Regjistrim (ARC)

Ju do të paiseni me Kartën e Aplikimit për Regjistrim (ARC). Kjo kartë është një dokument i rëndësishëm që tregon se keni bërë një aplikim për azil. Nëse nuk jeni pajisur me kartën tuaj ARC atëherë do t'ju jepet një letër standarde konfirmimi (SAL). Letra do të përmbajë të dhënat tuaja personale dhe fotografinë tuaj dhe do të konfirmojë se keni kërkuar azil. Ju do të merrni një letër që shpjegon se kur dhe ku ju mund të shkëmbeni SAL tuaj për një ARC. Nëse ju nuk merrni informacion në lidhje me këtë takim ju lutem telefononi Central Events Booking Unit (Cebu) në 0300 123 2235 - linjat janë hapur nga e Hëna deri të Premten 9.30pd - 3md.

Është e rëndësishme që të kontrolloni se të dhënat tuaja personale në kartën ARC janë të sakta. Duhet të siguroheni që emri, mbiemri, data juaj e lindjes dhe vendi i origjinës të jenë regjistruar saktë. Është e vështirë të ndërrohen këto të dhëna pasi të jenë regjistruar.

Karta juaj do të konfirmojë çdo kusht që ka të bëjë me statusin tuaj. Karta juaj ARC do të konfirmojë nëse lejoheni të punoni. Nëse përpara se të kërkonit azil nuk keni pasur leje pune, nuk do t'ju jepet leje pune pasi të bëni kërkesën për azil. Karta juaj do të thotë se nuk lejoheni të punësoheni.

Karta juaj ARC nuk provon identitetin tuaj, por regjistron identitetin që keni dhënë kur keni kërkuar azil. Karta ARC do t'ju nevojitet kur të merrni mbështetjen tuaj financiare, nëse kualifikoheni për të.

Do t'ju jepet një kartë ARC për secilin pjesëtar të familjes. Është e rëndësishme që kartën ta mbani të sigurt. Nëse ju jeni një azilkërkuar ose azilkërkuar i dështuar mbi 18 vjeç dhe ju ose personat që keni në ngarkim keni humbur, ju është vjedhur ose dëmtuar ARC(Karta) ju lutem kontaktoni Asylum Help te cilët do t'ju ndihmojë për të raportuar atë në Home Office.

Nëse keni status në Mbretërinë e Bashkuar, ose jeni i mitur, ju lutem kontaktoni Home Office direkt në 0300 123 2235 për të raportuar kartën tuaj të humbur, vjedhur ose të dëmtuar.

Nëse merrni mbështetje javore nga Zyra e Postës duke përdorur kartën tuaj ARC, do t'ju duhet të njoftoni edhe seksionin e mbështetjes së azilit. Kur të telefononi Asylum Advice UK në 0808 8000 620 ju lutemi të keni gati këtë informacion. Detajet e ekipit që merret me mbështetjen tuaj mund t'i gjeni në çdo letër të Home Office që ka të bëjë me akomodimin dhe mbështetjen tuaj financiare. Ata mund të organizojnë që t'ju dërgohen të holla emergjence ndërkohë që organizohet karta juaj ARC. Ka të ngjarë që një takim do të organizohet në qendrën tuaj lokale të raportimit për të terhequr ARC(kartën) tuaj të re. Ju do të duhet të paguani vetë shpenzimet e udhëtimit tuaj për këtë takim.

Nëse ju nevojiten më shumë këshilla dhe udhëzime në lidhje me këtë, mund të kontaktoni Asylum Advice UK në 0808 8000 620.

Pasi të keni marrë kartën tuaj ARC mbështetja juaj e rregullt do të rrifillojë përsëri në ARC(kartën) tuaj.

2.11 Kërkesat për raportim – IS96

Mund t'ju jetë thënë që të raportoni në një zyrë imigracioni në një orë të caktuar çdo javë/muaj. Do t'ju jepet një dokument i quajtur IS96 që konfirmon kushtet tuaja të raportimit dhe shpjegon detajet e pranimit tuaj të përkohshëm në MB.

Shumica e kërkuarve të azilit që nuk janë të ndaluar pritjet që të raportojnë në një qendër raportimi ose rajon policie.

Nëse jeni aplikues për azil që jetoni tre milje (4.85 km) ose më larg nga qendra e raportimit dhe merrni mbështetje nga Home Office, mund të kualifikoheni që të merrni ndihmë me biletat e udhëtimit për raportimin. Ju duhet që për të raportuar për herë të parë të merrni me vete prova që po merrni mbështetje nga Home Office. Më pas do t'ju jepen biletat në mënyrë që të raportoni. Këto normalisht do t'ju jepen në qendrën e raportimit. Në shumicën e rasteve duhet ta organizoni vetë udhëtimin për në raportimin tuaj të parë. Kostoja për këtë gjë nuk do t'ju kthehet.

Sa herë që raportoni duhet të tregoni formularin tuaj IS96 dhe kartën ARC (vetëm nëse kjo e fundit ju është dhënë).

Nëse nuk mbështeteni nga Home Office mund të aplikoni për bileta udhëtimi nëse ka rrethana të jashtëzakonshme. Kur të raportoni do t'ju duhet të kërkonti një "Formular kërkesë të jashtëzakonshëm për udhëtim" nga oficeri i imigracionit. Duhet të dorëzoni një kërkesë me shkrim dhe prova se nuk mund ta financoni vetë udhëtimin.

2.12 Nëse nuk raportoni

Është e rëndësishme që ju të paraqiteni në të gjitha rastet e raportimit. Nëse nuk jeni në gjendje të raportoni atëherë duhet të kontaktoni qendrën e raportimit (në numrin e dhënë në formularin IS96) përpara datës tuaj të raportimit dhe të kërkonti që raportimi të pezullohet. Ju duhet të paraqisni prova për të mbështetur kërkesën tuaj. Për shembull nëse nuk mund të raportoni për shkak të një sëmundjeje duhet të paraqisni prova mjekësore.

Nëse jeni në tremujorin e fundit të shtatzënisë mund të kërkonti që raportimi t'ju pezullohet deri pas lindjes së fëmijës tuaj. Duhet të paraqiteni në qendrën e raportimit me certifikatën tuaj të shtatzënisë (MAT B1). Atë mund ta merrni nga doktori ose nga vizitorja juaj e shëndetit. Qendra e raportimit më pas mund ta shtyjë raportimin tuaj deri pas lindjes së fëmijës tuaj. Nëse ju nuk jeni në gjendje të raportoni është e rëndësishme që ju të kontaktoni qendrën e raportimit ose kontaktoni përfaqësuesin tuaj ligjor i cili mund t'ju ndihmojë me këtë çështje.

2.13 Dokumentet që ju duhen kur raportoni

Kur shkoni në qendrën e raportimit duhet të merrni me vete dokumentin e raportimit IS96 dhe kartën tuaj ARC. Qendrat e raportimit do ta rifreskojnë kartën tuaj ARC që të konfirmojë se i keni zbatuar kërkesat tuaja për raportim dhe pranimin në Mbretërinë e Bashkuar. Nëse nuk paraqiteni për të raportuar ose nëse harroni kartën tuaj atëherë karta është programuar që t'i thotë Zyrës së Postës të mos jua lëshojë mbështetjen derisa të kontaktoni qendrën e raportimit dhe karta juaj të rifreskohet. Zyra e Postës do t'ju lëshojë një faturë defekti me kodin 4. Nëse nuk paraqiteni për të raportuar dhe nuk kontaktoni Home Office, atëherë mbështetja juaj do të pezullohet dhe në disa raste mbështetja juaj mund të ndërpritet. Ju duhet të prezantoheni në qendrën tuaj lokale të raportimit për të rifreskuar kartën tuaj që do t'ju mundësojë vazhdimin e mbështetjes.

2.14 Këshillat ligjore

Është e rëndësishme që ju të flisni me një këshilltar ligjor sa më parë që të jetë e mundur.

Këshilltari ligjor mund t'ju ndihmojë me informacion në lidhje me procesin e azilit, do t'ju ndihmojë të përktheni dokumentet tuaja dhe do të organizojë që çdo raport shtesë t'i paraqitet Home Office.

Ju duhet të siguroheni që këshilltari juaj ligjor të jetë i regjistruar me një nga organizatat e mëposhtme:

- Law Society të Anglisë dhe Uellsit si avokat i kualifikuar
- Law Society të Skocisë si avokat i kualifikuar
- Law Society të Irlandës së Veriut si avokat i kualifikuar
- Office of the Immigration Services Commissioner (OISC), që ka një regjistër të këshilltarëve që janë në nivelin 2 ose 3. Niveli 2 ose 3 do të thotë se këshilltari është i kualifikuar t'ju japë këshilla në lidhje me aplikimin tuaj për azil dhe t'ju përfaqësojë në të gjitha çështjet e azilit.
- Ju duhet ta pyesni avokatin tuaj se me kë janë të regjistruar. Emblemat e organizatave të mësipërme duhet të jenë në gjithë letrat që merrni nga përfaqësuesi juaj ligjor. Ju do të mund të kontrolloni edhe direkt me organizatën nëse këshilltari juaj ligjor është regjistruar me ta.

Këshillat Ligjore Falas

Si kërkues i azilit mund të kualifikoheni për këshilla ligjore falas nëse plotësoni kriteret për Ndhimë Ligjore. Ju do të klasifikoheni si azilkërkues pasi të jeni regjistruar plotësisht. Që të kualifikoheni për ndihmë ligjore duhet të provoni se keni të ardhura të ulëta dhe se çështja juaj ka një mundësi të vërtetë që të dalë me sukses.

Ndhimë Ligjore në Angli dhe Uells

The Legal Aid Agency mbikëqyr Ndhimën Ligjore.

Për të gjetur një këshilltar ligjor:

Law Society:

<http://www.lawsociety.org.uk/find-a-solicitor/>

Direct Gov:

<https://www.gov.uk/find-a-legal-adviser>

OISC – Level 2 / level 3 (Specialist):

http://oisc.homeoffice.gov.uk/how_to_find_a_regulated_immigration_adviser

Mund të kontaktoni edhe:

Asylum Advice UK - 0808 8000 620
www.asylumhelpuk.org

Ndihma Ligjore në Skoci

Scottish Legal Aid Board administron Ndhimën Ligjore. Informacion i mëtejshëm mbi Ndhimën Ligjore mund të merret te: 0845 122 8686

Për të gjetur një këshilltar ligjor:

Scottish Legal Aid Board:

<http://www.slab.org.uk/public/solicitor-finder/#register>

OISC:

http://oisc.homeoffice.gov.uk/how_to_find_a_regulated_immigration_adviser

The Law Society of Scotland:

0131 226 7411 / www.lawscot.org.uk

Ndihma ligjore në Irlandën e Veriut

Northern Ireland Legal Services Commission administron Ndhimën Ligjore në Irlandën e Veriut.

Për të gjetur një përfaqësues ligjor:

Northern Ireland Legal Services Commission:

<http://www.nilsc.org.uk/solicitors.asp?on=solicitors>

Law Society of Northern Ireland:

<http://www.lawsoc-ni.org/solicitors-directory/how-to-use-the-solicitors-directory>

OISC:

http://oisc.homeoffice.gov.uk/how_to_find_a_regulated_immigration_adviser

Kudo që ndodheni: në Angli, Uells, Irlandën e Veriut apo Skoci ju mund të kontaktoni edhe:

Asylum Advice UK - 0808 8000 620
www.asylumhelpuk.org

2.15 Si të ankoheni rreth këshillave të këqija ligjore:

Nëse mendoni se kemi marrë këshilla të këqija ligjore atëherë keni të drejtën të paraqisni një ankesë. Në ankesë duhet të përfshini ç'ka më poshtë:

- emrin, mbiemrin dhe të dhënat tuaja të kontaktit;
- të dhënat e plota të ankesës (përfshi orët, datat dhe vendet);
- të dhënat e çdo dëshmitari (nëse ka lidhje);
- kopje të letrave ose dokumenteve përkatëse;
- Numrin e referencës së çështjes tuaj

Kur e takoni për herë të parë këshilltarin tuaj ligjor ata duhet t'ju kenë dhënë një letër të kujdesit për klientin. Kjo letër konfirmon punën që ata do të bëjnë për ju si dhe procedurën e tyre të ankesave. Në të do të konfirmohet edhe sa kohë do të duhet për të hetuar ankesën tuaj.

2.16 Ndryshimet në rrethana

Ju duhet të njoftoni Home Office për çdo ndryshim në rrethanat tuaja.

Kjo përfshin:

- Një ndryshim në emrin tuaj.
- Marrjen ose aksesin te paratë që nuk i keni përmendur më parë.
- Marrjen ose aksesin te paratë pasi keni shitur diçka.
- Transferimi në një banesë tjetër.
- Martesa, divorci ose ndarja nga partneri.
- Formimi i një partneriteti civil ose vendimi për të jetuar me partnerin tuaj.
- Shtrimi në spital.
- Ju (ose partnerja juaj) mbeteni shtatzënë ose ju lind një fëmijë.
- Gjithë fëmijët që mbarojnë shkollën ose largohen nga shtëpia.
- Çdo pjesëtar tjetër të familjes që ju bashkohet ose largohet nga ju në Mbretërinë e Bashkuar.
- Gjithë personat e tjerë që ju bashkohen ose largohen prej jush në akomodimin tuaj.
- Burgimin.
- Punësimin ose papunësimin.
- Shtatëzaninë

- Ndryshim rrethanash nga marrja e akomodimit dhe mbështetjes financiare në mbështetje vetëm financiare dhe anashjelltas

Është e rëndësishme që të njoftohet Home Office për çdo ndryshim në rrethanat tuaja sepse ato mund të ndikojnë mbi mundësinë tuaj për të marrë mbështetje.

Asylum Help do t'ju ndihmojë për të njoftuar repartin e mbështetjes në Home Office për çdo ndryshim rrethanash, ju lutemi kontaktoni:

Asylum Support Application UK - 0808 8000 621
www.asylumhelpuk.org

Është e rëndësishme që ju të njoftoni përfaqësuesin tuaj ligjor dhe/ose pjesën e imigracionit të Home Office për çdo ndryshim të rrethanave tuaja.

2.17 Kujdesi shëndetësor

Ju keni të drejtën të përdorni kujdesin e Shërbimit Kombëtar Shëndetësor (NHS) pa pagesë ndërkohë që kërkoni azil ose ndërkohë që shqyrtohet kërkesa juaj për azil. Nëse jeni strehuar në një akomodim fillestar, do t'ju referojnë te një kontroll mjekësor pasi të shkoni në akomodimin tuaj.

Nëse nuk jeni në akomodimin fillestar ose jeni shpërndarë, duhet të regjistroheni te doktori, i njohur si doktori i përgjithshëm (GP), sa më parë që të jetë e mundur, në mënyrë që të merrni kujdes shëndetësor nëse ju nevojitet. Për t'u regjistruar do t'ju duhet të jepni emrin, mbiemrin, datën e lindjes, adresën dhe numrin e telefonit nëse keni. Do t'ju duhet të plotësoni një formular të kontrollit për regjistrimin e pacientëve të rinj. Ju gjithashtu mund t'ju kërkohet të tregoni kartën tuaj ARC për të vërtetuar se ju jeni një azilkërkues dhe keni të drejtën e kujdesit shëndetësor falas.

Nëse mbështeteni në bazë të seksionit 95 të Aktit të Emigracionit dhe Azilit, duhet të merrni një formular të çertifikatës së shëndetësisë të njohur si çertifikata HC2. Kjo çertifikatë do t'ju jepet ju në akomodimin fillestar ose si pjesë e informacionit që merrni 18 ditë pasi të hyni në akomodimin tuaj afatgjatë. Nëse nuk po merrni mbështetje nga Home Office duhet të merrni vetë një formular HC1. Të dhënat mund të merren nga një doktori i përgjithshëm ose nga Department of Work and Pensions. Çertifikata HC2 është zakonisht e vlefshme për gjashtë muaj. Për të rinovuar një çertifikatë HC2 ju duhet të plotësoni një formular të ri HC1. Ky mund të kërkohet nga linku i mëposhtëm: <http://www.nhs.uk/HealthCosts/1128.aspx>. Ju gjithashtu mund të merrni formularin nga Jobcentre, dentisti, okulisti dhe farmacia.

Një formular HC2 do t'ju mundësojë të merrni:

- Receta të NHS (falas për banorët e Skocisë dhe Uellsit)
- Trajtime dentare nga NHS (jo kozmetike)
- Kontrolle të shikimit
- Syzet dhe lentet e kontaktit (okulistët do të konfirmojnë koston maksimale që mund të zbatohet për ju)
- Kostot e nevojshme të udhëtimit për të marrë trajtimin nga NHS nga një konsulent
- Paruke dhe mjete prej cohe nga NHS- për shembull sende mbështetëse për shpinën ose barkun dhënë nga një spital (falas për banorët në Skoci dhe Uells).

Nëse mendoni se mund të keni turbekuloz (TB) ose ndonjë sëmundje tjetër ngjitëse duhet të kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore. Nëse jeni të strehuar në një banesë të përkohshme në Skoci ju do të merrni të dhënat e doktorit personal (GP) para se të largoheni prej këtij stehimi. Në Skoci, azilkërkuesit mund të përdorin shërbimet e NHS për aq kohë sa ata mbeten në Britaninë e Bashkuar pamvarësisht se kanë apo jo një kërkesë në vazhdim për azil.

2.18 Pagesat e shtatëzanisë

Një shumë të vetme, një pagesë e lindjes prej £300 mund të jepet për nënat e reja në mbështetje të azilit për të ndihmuar me shpenzimet që rrjedhin nga lindja e një fëmije të ri. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim jo më herët se tetë javë para lindjes së fëmijës ose gjashtë javë pas lindjes. Ju duhet të përfshijë evidencën e datës së parapritur të lindjes (formë MATB1), ose certifikatën e plotë të lindjes së fëmijës. Paga duhet të bëhet me vlerën e £300 për fëmijë, kështu që nëse prisni binjakë, atëherë £600 do të paguhet. Nëse ju merrni mbështetje të Seksionit 4 , kërkoni £250 jo më parë se tetë javë para lindjes së fëmijës ose gjashtë javë pas lindjes.

Të gjitha gratë që marrin përkrahje për azil dhe që janë shtatzëna apo kanë fëmijë nën moshën tre vjeçare, kanë të drejtë të pagesave shtesë. Një shtesë £5 në javë është në dispozicion për foshnjat nën moshën një vjeçare. Gratë shtatzëna dhe fëmijët e moshave një deri më tre vjet kanë të drejtë për një shtesë £3 mbi pagesën bazë të tyre të mbështetjes për azil.

2.19 Dhuna në familje

Dhuna në familje është çdo incident i sjelljes kërcënuese, dhuna dhe abuzimi në mes të të rriturve që janë apo kanë qenë në një marrëdhënie së bashku, mes anëtarëve të familjes, ose në mes të njerëzve të tjerë të cilët jetojnë ose kanë jetuar në të njëjtën shtëpi / banesë pavarësisht nga gjinia e tyre apo orientimi seksual.

Dhuna në familje mund të ndikojë gjithkë në çdo kohë. Si burrat dhe gratë mund të

preken nga kjo dhunë pavarësisht se me kë jetojnë dhe marrëdhëniet që kanë me atë person. Nëse ndiheni të detyruar të jetoni me këtë sjellje, qoftë si viktimë apo dëshmitar, është e rëndësishme të kuptoni se ju mund të kërkonti ndihmë. Gjithkush ka të drejtë për mbrojtje nga dhuna në familje, pavarësisht nga statusi i tyre i imigracionit.

Ju mund të raportoni abuzimet tek: linja telefonike ndihmëse 24 orëshe kudra dhunës shtëpijake (0808 2000 247 - thirrjet janë pa pagesë), policia, mjeku juaj, vizitorja shëndetësore, agjencitë e refugjatëve, grupet mbështetëse lokale.

Ju mund të kërkonti të flisni me një punëtore femër dhe/ose një përkthyes femër në qoftë se preferoni. Informacioni që ju të jepni do të mbahen privat.

2.20 Kthimi vullnetar

Nëse pas regjistrimit vendosni që doni të ktheheni në atdhe për shkak të një ndryshimi në rrethanat tuaja dhe nuk dëshironi ta vazhdoni kërkesën tuaj për azil, atëherë mund të kontaktoni programin e Kthimit Vullnetar të Asistuar drejtuar nga Home Office. Per më tepër informacion vizitoni: www.gov.uk/return-home-voluntarily Departamenti i nisjes vullnetare: 0300 004 0202

Nëse vendosni se nuk doni të kërkonti azil dhe jeni një migrant i parregullt e dëshironi të ktheheni në atdhe, mund të merrni ndihmë dhe mbështetje prej programit të Kthimit Vullnetar të Asistuar drejtuar nga Home Office. Per më tepër informacion vizitoni: www.gov.uk/return-home-voluntarily Departamenti i nisjes vullnetare: 0300 004 0202

2.21 Çfarë ndodh më tej?

Pas regjistrimit, do të organizohet një intervistë e zgjeruar. Është e rëndësishme të gjeni një këshilltar ligjor përpara kësaj faze në mënyrë që ata të mund të përkthejnë dhe paraqesin provat që keni përpara intervistës tuaj për azil. Ju lutemi shikoni pjesën përpara intervistës së zgjeruar.

Bërja e një ankese rreth Asylum Help

Të gjithë ata që përdorin shërbimet e Migrant Help mund të ankohen.

Nëse keni probleme me një nga shërbimet tona, atëherë ja se çfarë duhet të bëni:

Ngrijeni çështjen sa më parë që të jetë e mundur me një anëtar të personelit ose një vullnetar. Nëse ankesa nuk zgjidhet kënaqshëm në mënyrë jo zyrtare, atëherë mund të bëni një ankese me shkrim, duke përdorur Formularin e Ankesës. Këtë mund ta bëni duke telefonuar Asylum Advice UK në numrin 0808 8000 620 ose duke shkarkuar formularin nga faqja e internetit në www.asylumhelpuk.org. Ankesën duhet t'ia drejtoni menaxherit të shërbimeve për të cilat doni të ankoheni. Nuk është e nevojshme që

ankesat të shkruhen në anglisht. Ato mund të shkruhen në gjuhën tuaj dhe Asylum Help do t'i përkthejë. Menaxheri do ta hetojë ankesën dhe do t'ju kthejë përgjigje. Nëse nuk mund t'ju ofrojmë menjëherë një përgjigje të kënaqshme, do t'ju japim një përgjigje të plotë me shkrim e cila përfshin detaje të çdo veprimi ndreqës brenda 10 ditësh pune.

Nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatin e ankesës tuaj, mund ta çoni çështjen më tej duke kontaktuar Oficerin e Ankesave, Complaints Officer, Migrant Help, Charlton House, Dover, CT16 1AT. Nëse përsëri nuk jeni të kënaqur me këtë përgjigje, pamundësia për ta zgjidhur ankesën do të regjistrohet dhe ne do t'ju këshillojmë për organizata të tjera të mundshme të cilat mund ta raportojnë ankesën tuaj.

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me çdo pjesë të këtij seksioni, ju lutemi kontaktoni Asylum Help:

www.asylumhelpuk.org

Asylum Advice UK 0808 8000 620

Asylum Support Application UK 0808 8000 621